




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 08.12.2022

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

F t e s ë

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në takimin kordinues me Shefat e Grupeve Parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës të datës 08.12.2022 dhe kërkesës Nr. 262, të datës 07.12.2022 nga Grupi i anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje me nënshkrime, nenin 44.1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, nenin 31.3 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 8, paragrafi 1, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 62, të datës 16.05.2013, ju fton të merrni pjesë në mbledhjen e njëmbëdhjetë (e jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë 12.12.2022, filluar në orën 10:00h. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, me këtë:

REND DITE

1. Diskutim lidhur me fushatën 'Gjashtëmbëdhjetë (16) ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore'.
2. Raportimi i Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje.

Pjesëmarrja është e obliguar!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



Për:	z.Ali Ismaili, Kryesues i Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës
Nga:	Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës
Date:	06.12.2022
Lënda:	Kërkesë për seancë të jashtëzakonshme në lidhje me fushatën "16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore".




I nderuari Kryesues,

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Republikën e Kosovës, respektivisht në përputhje me nenin 44.1, që përcakton se "Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit. Dhe Neni 44.2 që thekson se "E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

Po ashtu në mbështetje të nenit 44.3 dhe 44.4, si dhe bazuar në rregulloren komunale të Kuvendit Komunal, shtrojmë kërkesën për seancë të jashtëzakonshme. Kjo kërkesë vije me rastin e fushatës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore"

Seanca do të mbahet me datë: 12.12.2022 nga ora 10:00, ku propozohet të ketë këtë rend të ditës:

1. Diskutim lidhur me fushatën "16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore"
2. Raportimi i Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje

Emri	Mbiemri	Subjekti	Nënshkrimi
1. VILONJAT	HASANI	LUV	
2. EGLANTINA	AZEMI	LUV	
3. HASIME	KOSTANICA	LUV	
4. DURIM	HAJRA	LUV	
5. SHPENQ	BARDOQI	LUV	
6. HABIB	MEKOLLI	LUV	
7. HASAN	ISMAILI	AAK	
8. ALI	ISMAILI	PD	
9. DARDANE	JOGOJEVA	POK	
10. AIDA	ALIMI	POK	
11. Ardan	Asllani	LN	
12. Berdise	Adonij	IFKEA	